

Emertimi dhe Forma ligjore	UJESJELLES KANALIZIME TIRANE SH.A
NIPT-i	J 62005002 O
Adresa e Selise	Rruga "5 Maji", prane Medreses <u>TIRANE</u>
Data e krijimit	28.12.2000
Nr. i Regjistrimit	24875
Veprimtaria kryesore	PRODHIM DHE FURNIZIM ME UJE

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standarteve Nderkombetar te Kontabilitetit dhe Ligjit nr.9228, date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

Viti 2010

Pasqyrat Financiare jane individuale	<u>v</u>
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne	<u>Lek</u>
Pasqyrat Financiare jane te rrumbullakosura ne	<u>-</u>
Periudha kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga 01.01.2010
	<u>Deri 31.12.2010</u>
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare	<u>03.03.2011</u>

UKT sh.a.
Ujesjelles Kanalizime Tirane

Pasqyrat Financiare
Për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

Permbajta

	<u>Faqe</u>
Pasqyra e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2010	1
Pasqyra e të ardhurave për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2010	2
Pasqyra e ndryshimit të kapitaleve të veta për periudhën e mbyllur më 31 .12.2010	3-4
Pasqyra e rrjedhjes së parasë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2010	5
Shënime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010	6 – 25

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

Shenime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
AKTIVE		
Aktive afat gjate		
Aktive afat gjate materiale	6 8,244,516,562	8,091,436,484
Te tjera aktive afat gjate	7 445,929,705	443,326,815
	8,690,446,267	8,534,763,299
Aktive qarkulluese		
Inventari	8 232,608,539	126,482,421
Kliente (neto)	9 1,060,019,271	984,304,255
Te tjera aktive qarkulluese	10 24,777,042	11,096,053
Likuiditete	11 41,717,869	51,858,559
	1,359,122,721	1,173,741,288
	10,049,568,988	9,708,504,587
KAPITALET E VETA		
Kapitali	12 2,561,571,000	2,561,571,000
Rezerva statutore	12 66,255,787	66,391,287
Rezerva ligjore	12 3,680,738	3,680,738
Rezerva rivleresimi	12 2,700,676,118	2,700,676,118
Fitim (humbje) të pa shperndara	12 (2,036,388,426)	(1,304,050,202)
Fitim (humbje) e vitit ushtrimor	12 245,620,761	(732,338,222)
	3,541,415,978	3,295,930,719
DETYRIME		
Detyrime afat gjate		
Hua afat gjate	13 5,088,146,153	5,228,877,361
Grante	14 568,269,995	538,003,206
	5,656,416,148	5,766,880,567
Detyrime afat shkurter		
Llogari te pagueshme (furniture)	15 272,341,453	146,679,452
Kesti afat shkurter i huase afat gjate	13 139,355,831	138,542,412
Hua afat shkurter	16 304,592,071	233,542,955
Detyrime ndaj punonjesve	17 32,922,558	24,071,523
Te tjera detyrime afat shkurter	18 102,524,949	102,856,959
	851,736,862	645,693,301
	10,049,568,988	9,708,504,587

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar ne lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 6-25 te cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën e mbyllur në 31.12.2010
(Shumat janë shprehur në Lek. përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

Shenime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Shitje neto	19	1,920,518,313
Te ardhura tjera	19	53,183,979
	1,973,702,292	1,184,308,758
Shpenzime operacionale	20	(533,073,555)
Paga dhe shperblime	21	(592,194,174)
Amortizimi	6	(542,548,899)
Te tjera shpenzime	22	(35,822,335)
	(1,703,638,693)	(1,565,326,878)
Rezultati nga aktiviteti kryesor	270,063,329	(368,136,459)
Të ardhura nga grantet		14,595,857
Shpenzime per interesa huaje		(33,474,256)
Humbje nga diferenca konvertimi		(24,851,211)
Te ardhura (shpenzime) financiare		19,287,042
<i>Shpenzime financiare- neto</i>		(24,442,568)
		34,840,162
Fitimi përpara tatimit		245,620,761
Tatim fitimi		0
Fitimi (humbje) neto për periudhën		(732,338,222)
Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë	0	0
Rivlerësime të pasurive të paluajtshme	0	0
Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse	0	0
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse (neto nga tatimi)	0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	245,620,761	(732,338,222)

Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar ne lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 6-25 te cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën e mbyllur në 31.12.2010
 (vazhdon)

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

Shenime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Fitim i atribuar për:		
Aksionerët e Shoqërisë	245,620,761	(732,338,222)
Te tjera aksione në minorance	0	0
Fitimi i periudhës	245,620,761	(732,338,222)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse i atribuar për:		
Aksionerët e Shoqërisë	245,620,761	(732,338,222)
Te tjera aksione në minorance	0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	245,620,761	(732,338,222)

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 6-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e veta për periudhën e mbyllur më 31.12.2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rasisë kur specifikohet monedha tjetër)

	Kapital	Rezerva Ligj. Stat.	Rezerva Tjera	Fitimi i mbartur	Totali
Balanca në 31 Dhjetor 2008	2,561,571,000	66,253,283	2,704,664,860	338,174,025	5,670,663,168
Efekte të ndryshimeve në politikën kontabël					
Aplikimi për herë të parë i SNRF-ve				(1,642,224,227)	(1,642,224,227)
Pozicioni i rregulluar me datë 01.01.2009	2,561,571,000	66,253,283	2,704,664,860	(1,304,050,202)	4,028,438,941
Totali i fitimit gjithëpërfshirës për periudhën					
Fitim (humbje) për vitin 2009				(732,338,222)	(732,338,222)
Te tjera të ardhura gjithëpërfshirëse					0
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse					0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	2,561,571,000	62,394,823	2,705,096,260	(2,036,388,424)	3,296,100,719
Kontribute / shpërndarje tek aksionerët					
Divident të paguar aksionereve					0
Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave			(170,000)		(170,000)
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes për aksionerët			(170,000)		(170,000)
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit					0
Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve					0
Totali i transaksioneve me aksionerët					0
Balanca në 31 Dhjetor 2009	2,561,571,000	66,253,283	2,704,494,860	(2,036,388,424)	3,295,930,719

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e veta për periudhën e mbyllur më 31.12.2010 (vazhdon)

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rasteve kur specifikohet monedha tjetër)

	Kapital	Rezerva Ligj. Stat.	Rezerva Tjera	Fitimi i mbartur	Totali
Balanca në 31 Dhjetor 2009	2,561,571,000	66,253,283	2,704,494,860	(2,036,388,424)	3,295,930,717
Fitim (humbje) per periudhen 2010				245,620,761	245,620,761
Te tjera te ardhura gjithëpërfshirëse					0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	2,561,571,000	66,253,283	2,704,494,860	(1,790,767,663)	3,541,551,478
Kontribute / shpërndarje tek aksionerët					0
Divident te paguar aksionereve					0
Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave			(135,500)		(135,500)
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes për aksionerët			(135,500)		(135,500)
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit					0
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit					0
Totali i ndryshimeve ne zotërimin e aksioneve					0
Totali i transaksioneve me aksionerët			(135,500)		(135,500)
Balanca në 31 Dhjetor 2010	2,561,571,000	66,253,283	2,704,359,360	(1,790,767,663)	3,541,415,978

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e veta duhet lexuar në lidhje me shënime të shpjeguesh në faqet 6-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve monetare per periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Aktiviteti operues		
Fitimi neto i periudhës	245,620,761	(732,338,222)
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	542,548,899	703,168,870
Humbje (fitim) nga nxjerrja/shitja e AAM	0	0
Efekte te aplikimit te SNRF 2009	0	178,646,866
Shpenzime per tatim fitimi	0	0
Shpenzime per interesa	33,474,256	32,925,402
Të ardhura nga rimarrja e granteve	(14,595,857)	(34,840,162)
Ndryshime ne kapitalin qarkullues:	0	
Ndryshime ne llogarite e arketueshme	(233,825,086)	(403,733,138)
Ndryshime ne llogarite e pagueshme	157,064,982	257,242,512
Ndryshime ne llogarite e inventareve	(106,126,118)	11,422,098
Mjete monetare nga aktiviteti kryesor	624,161,836	12,494,226
Tatim fitimi i paguar	12,768,116	(4,800,000)
Interesa të paguara	(32,948,464)	(33,021,327)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operues	578,445,257	(25,327,101)
Aktiviteti investues		
Shtesa ne Aktive Afatgjate Mat. (AMM)	(535,459,531)	(11,499,115)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investues	(535,459,531)	(11,499,115)
Aktiviteti financues		
Divident i paguar	0	0
Grante per investime	43,254,474	2,832,340
Ndryshime ne perdorimin e rezervave	(135,500)	(170,000)
Financime dhe (ripagim) i huave	(96,245,390)	(10,000,000)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti financues	(53,126,416)	(7,337,660)
Rritje (ulje) neto e mjeteve monetare	(10,140,690)	(44,163,876)
Mjete monetare ne fillim te periudhes	51,858,559	96,022,435
Mjete monetare në 31 Dhjetor	41,717,869	51,858,559

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar ne lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 6-25 te cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

1. Të përgjithshme

UKT sh.a është themeluar më 15.12.2000 ne Tirane, dhe zyrat qendrore te saj jane ne adresen: Rruga 5 Maji, prane Medresese Tirane.

Aktiviteti i Shoqerise eshte furnizimi me uje i konsumatoreve familjare, subjekteve private, dhe enteve publike te qytetit te Tiranës dhe disa komunave dhe bashkive ne rrethinat e qytetit te Tiranës si Komuna Farke, Komuna Dajt, Bashkia Kamez, etj.

Aktiviteti i saj rregullohet me Ligj Nr. 8102 date 28.03.1996 "Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura". Shoqeria eshte teresisht me kapital shteteror.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata për pajtueshmëri

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në vlerën e drejte.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare jane pasqyruar ne LEK e cila eshte monedha funksionale e Shoqerise.

(d) Përdorimi i gjykimeve dhe hamendësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SNRF-ve, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në cdo periudhë të ardhme që preket.

(e) Ndryshime ne politikat kontabël

Duke nisur nga 1 Janar 2009, Shoqeria ka ndryshuar politikat kontabël në paraqitjen e Pasqyrave Financiare duke aplikuar Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF). SNRF 1 Aplikimi per here te pare i SNRF, kerkon qe raportimet e meparshme (dmth pasqyrat financiare te mbyllura 31.12.2009) te rishikohen qe nga data 01.01.2009 me qellim qe ne pasqyrat financiare te rishikuara te paraqiten te gjitha ato aktive dhe detyrime qe rrjedhin nga ndryshimi i politikave kontabel per shkak te aplikimit per here ta pare te SNRF.

Shoqeria ndjek SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (2007) të rishikuar, efektive në 1 Janar 2009. Si rezultat, Shoqeria paraqet në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit të gjitha ndryshimet në kapital, ndërsa të gjitha ndryshimet që nuk burojnë nga pronarët paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

2 Bazat e përgatitjes (vazhdon)

(f) Riparazitja e pasqyrave financiare te vitit 2009

Informacioni financiar i vitit të mbyllur me 31 Dhjetor 2009 është riparaqitur konform standartit të rishikuar.

		31 Dhjetor 2009	Efekti i riparaqitjes	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
AKTIVE				
<i>Aktive afat gjate</i>				
<i>Aktive afat gjate materiale – AAM</i>				
<i>(Toka, ndertesa, makineri paisje neto)</i>	a	8,072,554,832	18,881,652	8,091,436,484
<i>Aktive afatgjate jo materiale</i>	b	508,436,544	(508,436,544)	0
<i>Te tjera aktive afat gjate</i>	c	0	443,326,815	443,326,815
		8,580,991,376	(46,228,077)	8,534,763,299
<i>Aktive afat shkurter</i>				
<i>Inventari</i>	d	126,482,421		126,482,421
<i>Llogari per tu arketuar kliente (neto)</i>	e	2,016,401,622	(1,032,097,367)	984,304,255
<i>Te tjera aktive afat shkurter</i>	f	14,570,233	(3,474,180)	11,096,053
<i>Likujditete</i>		51,858,559		51,858,559
		2,209,312,835	(1,035,571,547)	1,173,741,288
		10,790,304,211	(1,081,799,624)	9,708,504,587
KAPITALETE VETA				
<i>Kapitali</i>		2,561,571,000		2,561,571,000
<i>Rezerva statutore</i>		66,391,287		66,391,287
<i>Rezerva ligjore</i>		3,680,738		3,680,738
<i>Rezerva rivleresimi</i>		2,700,676,118		2,700,676,118
<i>Fitim (humbje) të pa shperndara</i>	g	338,174,025	(1,642,224,227)	(1,304,050,202)
<i>Fitim (humbje) e vitit ushtrimor</i>	h	(816,698,350)	84,360,128	(732,338,222)
		4,853,794,818	(1,557,864,099)	3,295,930,719
DETYRIME				
<i>Detyrime afat gjate</i>				
<i>Hua afat gjate</i>	i	4,785,550,546	443,326,815	5,228,877,361
<i>Grante</i>		538,003,206		538,003,206
		5,323,553,752	(443,326,815)	5,766,880,567
<i>Detyrime afat shkurter</i>				
<i>Llogari te pagueshme (furniture)</i>		146,679,452		146,679,452
<i>Kesti afat shkurter i huase afat gjate</i>	j	138,542,412		138,542,412
<i>Hua afat shkurter</i>	k	233,542,955		233,542,995
<i>Detyrime ndaj punonjesve</i>		24,071,523		24,071,523
<i>Te tjera detyrime afat shkurter</i>	l	70,119,299	32,737,660	102,856,959
		612,955,641	32,737,660	645,693,301
		10,790,304,211	(1,081,799,624)	9,708,504,587

Me shume informacion per efektet e riparaqitjes jepen me poshte:

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

2. Baza e pergatitjes (vazhdon)

(f) Riparaqitja e pasqyrave financiare te vitit 2009

a. Aktivet afatgjate materiale (AAM)

Shtesa e prej 18,881,652 Lek përfaqeson kryesisht ne korrigjimin e nje gabimi matematikor ne pasqyrat e ekspertit vleresues te aktiveve afat gjate materiale ne vitin 2006, ku nje element i AAM (tubo xingato 1977) ishte paraqitur me vlere neto negative 7,305,757 lek. Ne fakt vlere e ketij aktivi ne 31.12.2006 duhet te ishte 11,090,065 Lek. Veprimi regullues perfshin dhe efektet e amortizimit te akumuluar negativ qe nga viti 2006 deri 2009 ne shumen prej 485,830 lek. Efektet e ketyre rregullimeve jane kaluar ne fitimin e mbartur ne bilancin e çeljes më 1 Janar 2009.

b. Aktive afatgjate jo materiale (AAJM)

Jane rishikuar aktivet afatgjate jo materiale te cilat perbehen nga vlere e disa projekteve te zhvilluara ne vitet e kaluara me synim trajnimin e punonjesve ne kuadrin e aplikimit te programeve te ristrukturimit te UKT sh.a. Nga ky rishikim u konkludua se keto aktive atate gjate jomateriale nuk plotësonin kriteret e njohjes sipas SNK 38 dhe ekzistonin të gjithë treguesit për çregjistrim e tyre dhe rregullimin e fitimit te mbartur ne bilancin e çeljes më 1 Janar 2009.

c. Te tjera aktive afat gjate

Shuma prej 443,326,815 Lek, eshte njohur si aktive te tjera afat gjate, e cila ka rezultuar nga nje proces rakordimi midis Shoqerise dhe Ministrise se Financave, per nen-huate qe i jane levruar Shoqerise UKT deri ne 31.12.2009. Nga rakordimi i teprices së huave afat gjate me Ministrine e Financave (MF), rezulton se ne daten 31.12.2009 shuma e disbursuar e huave sipas MF nuk perputhet me vleren e mbartur te huave ne bilancin e UKT sh.a. Per kete eshte bere njohja e detyrimit shtese sipas konfirmimit nga MF ne pasiv te bilancit duke rritur vleren e mbartur te huave me shumen e mesiperme. Si rrjedhim ne kunderparti, shoqeria ka njohur perkohesisht nje aktiv afat gjate deri ne momentin e sakesimit se per çfare jane perdorur fondet shtese te levruara nga MF prej 443,326,815 Lek. Shoqeria nuk ka aplikuar ndonje amortizim per keto aktive afat gjate deri sa te sqarohet menyra e perdorimit te tyre.

d. Inventare

Inventaret jane vleresuar me vleren e drejte.

e. Llogari per tu arketuar (kliente)

Eshte bere vleresimi i mbledhshmerise se klienteve dhe eshte arritur ne perfundimin se provizionet duhen ripare per te reflektuar me mire rrezikun e mosarketimit. Per kete arsye provizionet jane rritur ne ate shifer qe gjykohet e arsyeshme per te mbuluar rreziqet e mosarketimit.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdon)

(f) Riparaqitja e pasqyrave financiare te vitit 2009

f. Te tjera aktive afat shkurter

Ndryshimi neto prej 3,474,180 Lek reflekton riklasifikimin e disa llogarive individuale te grupit Debitore & Kreditore te tjere (Llog. 467) te cilet kishin teprice debitore por ishin grupuar ne pasiv te bilancit ne shumen 13,152,056 Lek. Gjithashtu eshte bere dhe rivleresimi i disa llogarive debitore dhe per ato qe jane te dyshimta eshte llogaritur provizion per rreziqe mos pagimi respektivisht ne shumen 7,604,664 lek per llogarite "467 Debitore te tjere" , dhe 9,021,572 Lek provizione mos arketimi per llogarine "413 Vlera per tu arketur".

g. Fitime te mbartura

Te gjitha efektet e riparaqitjes te cilat ndikojne rezultatin e viteve te meparshme jane pasqyruar ne zerin fitim (humbje) te mbartura.

h. Fitim humbje te periudhes

Nga rishikimi e transaksioneve te vitit 2009 jane bere rregullimet perkatese si ulja e shitjeve per fatura te anuluar ne vitin pasardhes, dhe anulimi i amortizimit te aktiveve afatgjate jo-materiale te cilat jane çrregjistruar.

i. Huaja afat gjate

Ne vijim te shenimit (c) me lart, shoqeria ka bere nje rakordim te te gjitha nen-huave te levruara nga institucionet perkatese te administrimit te huave (Ministria e Finances dhe DPUK). Nga ky rakordim ka rezultuar se shumate e levruara te huase jane me teper se shumate e njohura ne bilancin e UKT. Per keto diference (3.2 milion euro ose 443,326,815 Lek) eshte bere njohja ne zerin hua afatgjate dhe ne debi si nje aktiv provizor afat gjate deri ne momentin e saktesimit te perdorimit te kesaj huaje shtese.

j. Kesti afat shkurter i huase afat gjate

Kesti afat shkurter i huase afat gjate eshte pasqyruar si detyrim afatshkurter.

k. Hua afat shkurter

Shuma prej 233,542,995 Lek perfaqeson detyrimin qe UKT ka kundrejt MF per ato keste te huave, pagesa e te cilave eshte bere nga MF ne emer te UKT. Sipas nje marveshje te caktuar MF eshte garantuesi i ripagimit te huase kur shoqeria nuk ka mundesi per shlyerjen.

l. Detyrime te tjera afat shkurter

Shuma prej 32,737,660 Lek perfaqeson efektin e njohjes se detyrimeve per interesa kundrejt MF deri ne 31.12.2009 ne shumen 19,585,604 Lek sipas akt rakordimit perkates me MF si dhe riklasifikimin e disa tepricave debitore qe ishin grupuar me tepricat kreditore te llogarice 467 ne shumen 13,152,056 Lek.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Politikat kontabël të rendësishme

(a) Transaksionet ne monedha të huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë përkthyer me kursin e kembimit të datës së transaksionit. Aktivet monetare në monedha të huaja janë përkthyer në LEK me kursin në ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave të huaja në Leke janë përfshirë në fitim humbje. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhe të huaj të vlerësuar me vlerën e drejtë janë përkthyer në LEK me kursin e monedhës së huaj në datën e bilancit.

(b) Instrumentat financiarë

Shoqeria zotëron vetëm instrumenta financiare jo-derivative që përfshijnë llogari klientesh, mjete monetare, dhe llogari të tjera për tu paguar apo për tu arkëtuar me karakter tregetar. Llogarite e arketueshme dhe depozitat, njihen fillimisht në datën e krijimit të tyre. Te gjithë instrumentet e tjera financiare (përfshi dhe ata me vlerë të drejte nepermjet të ardhurave dhe shpenzimeve), njihen fillimisht në datën kur shoqeria behet pale kontraktuale e nje instrumenti.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi me pak se tre muaj të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqeria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arketueshme

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arketueshme janë vlerësuar me vlerën e drejte.

Llogarite e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme

Llogaritë e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me vlerën e drejte.

Të tjera

Instrumenta të tjera financiare jo-derivative janë vlerësuar me vlerën e drejte.

Kontabilizimi i të ardhurave financiare dhe shpenzimeve financiare jepet në paragrafin (h) të këtyre shpjegimeve për politikat kontabël.

(c) Toka, ndërtesa, makineri e paisje

(i) Njohja dhe matja

Toka, ndërtesa, makineritë e pajisjet maten me vlerën e drejte minus zhvlerësimin e akumuluar dhe cdo humbje të akumuluar nga çvlerësimi. Te gjitha aktivet afat gjate janë rivlerësuar në datën 31.12.2005 nga nje ekip vlerësuesish të pasurive të paluajtshme me vlerën e drejte.

Kur pjesë përbërëse të aktivitetit kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato mbahen si zëra të vecantë të aktiveve afatgjate materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një elementi të aktivitetit afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivitetit, dhe paraqiten neto në seksionin e të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Politikat kontabël të rendësishme (vazhdon)

(c) Toka, ndërtesa, makineri e paisje (vazhdon)

(ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese përbërëse të një prej aktiveve materiale afatgjata, njihet në vlerën e mbartur të aktivitetit, nëse është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga ky veprim dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e pjesës së zëvendësuar çrregjistrohet. Kostot e shërbimeve të përditëshme të aktiveve material afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet sipas metodes lineare duke pjestuar vlerën e zhvlerësueshme që është vlera e drejte e aktivitetit, ose ndonjë vlerë tjetër në vend të saj, me periudhën e pritshme të përdorimit, të cilat në formën e përqindjeve paraqiten si me poshtë:

	Norma e amortizimit	
	<u>Min</u>	<u>Max</u>
Ndërtesa	2	20
Makineri e paisje të aktivitetit kryesor	3	20
Rrjet kanalizime	2.5	15
Rrjet ujësjellësi	2	15
Mjete transporti në përdorim	10	16
Autovetura	10	16
Paisje zyre	20	30
Paisje kompjuterike	20	30

AAM në proces për qellime të përdorimit ose për qellime ende të pacaktuara, vlerësohen me kosto minus çdo kosto për demtimet. Kostoja përfshin çdo tarifë profesionale dhe në rast të disa asetëve të caktuara, shpenzimet e interesave kapitalizohen në përputhje me politikën e kontabilitetit të shoqërisë. Zhvlerësimi i aktiveve të tilla fillon kur ato janë gati për përdorim.

Aktive të përfutur si rrjedhojë e një qeraje financiare, zhvlerësohen mbi jetën e tyre të pritshme ashtu si dhe asetet e tjera të ngjashme. Në rast se jeta e tij e pritshme e përdorimit është me e ulët se e aktiveve të tjera, zbatohen afatet e qerave financiare.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga demtimi ose dalja jashtë përdorimit të një aseti, përcaktohen nga diferenca ndërmjet vlerës së përfutur të realizuar dhe vlerës së mbetur kontabël të asetit dhe kjo vlerë njihet si e ardhur apo shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Politikat kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(d) Çvlerësimi i aktiveve

(i) Aktivet financiare

Aktivitetet financiare vlerësohen në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për çvlerësim. Një aktiv financiar çvlerësohet nëse ka evidencë objektive që tregon se ka ndodhur një ngjarje humbjeje pas njohjes fillestare të aktivitetit që ndikon negativisht flukset e ardhshme monetare të vlerësuara për këtë aktiv dhe nëse këto flukse mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga çvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferenca mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të skontuara me interesin efektiv. Humbjet njihen si në llogaritë e fitim/humbjeve ashtu dhe në llogaritë e zbritjeve të arkëtueshmeve.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen individualisht për çvlerësim. Pjesa tjetër e aktiveve grupohen sipas karakteristikave të riskut të kredisë dhe vlerësohen në grup. Të gjitha humbjet nga çvlerësimi njihen në llogaritë e fitim humbjes.

Kur një ngjarje e mëpasshme ul shumën e njohur të humbjes nga çvlerësimi, ulja e humbjes nga çvlerësimi rimerret në llogaritë e fitim humbjes.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare me perjashtim të taksave të shtyra, rishikohet në çdo periudhë raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikator për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, atëherë bëhet vlerësimi i shumës së rikuperueshme të aktivitetit. Në këtë mënyrë një humbje nga zhvlerësimi regjistrohet nëse vlera e mbartur në kontabilitet e këtij aktivi e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Këto humbje nga zhvlerësimi pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi përcaktohet si me e madhja midis vlerës së tij të përdorimit dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në përcaktimin e vlerës së përdorimit, parashikimi i flukseve monetare skontohej për të aritur tek vlera aktuale duke përdorur normat e skontimit përpara taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe të rreziqeve specifike të këtij aktivi.

Humbjet nga çvlerësimi të regjistruara në periudhat e mëparshme rivlerësohen në çdo periudhë raportuese për të parë ndonjë indikator nëse këto humbje janë zvogeluar ose nuk ekzistojnë më. Një humbje nga çvlerësimi rishikohet nëse ka ndonjë ndryshim të parashikimeve të bera në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga rivlerësimi rishikohet deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur neto nga amortizimi, nëse kjo humbje nuk do të ishte regjistruar fare.

(e) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, kryen pagesa në emer të saj dhe të punonjësve të saj, për të kontribuar në skemat e pensionit në përputhje me legjislacionin lokal në fuqi. Kostoja e përballuar në emer të Shoqërisë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ashtu siç ndodhin.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. Politikat kontabël të rëndësishme (vazhdon)

(f) Provizionet për rreziqe

Provizionet për rreziqe pranohen kur Shoqeria ka një detyrim aktual (ligjor apo të pranuar tërthorazi), si rezultat i ndodhjeve në të kaluarën dhe ka gjasa që permbushja e këtyre detyrimeve kërkon sakrificimin e burimeve në pronesi të Shoqërisë të cilat do të sillnin përfitime ekonomike në të ardhmen, dhe Shoqeria ka mundësi të përcaktojë besueshëm vlerën e këtyre rreziqeve. Provizionet përcaktohen duke bërë skontimin e shumave të parashikuara për tu paguar në të ardhmen me normat e skontimit para tatimit që reflektojnë vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe të rreziqeve specifike të këtij detyrimi.

(g) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të kompanisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet. UKT sh.a një të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për furnizimin me ujë.

(h) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga diferencat e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

(i) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e shtyrë dhe atë aktual. Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përjashtuar rastet kur lidhet me zërat e kapitalit e për rrjedhim paraqitet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i parashikuar për tu paguar, i përlogaritur mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit si dhe cdo korrigjim të tatimit të pagueshëm të periudhave të mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato kanë mundësi të mbulojnë nga përfitimet e ardhshme tatimore. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në cdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor.

4. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një pjesë e politikave kontabël dhe shënimeve shpjeguese të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare ose jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të matjes apo shënimeve sipas metodave të mëposhtme.

(i) Toka, ndërtesa, makineri e pajisje

Vlera e tregut të ndërtesave është shuma me të cilën mund të shkëmbejë një aktiv në datën e vlerësimit midis palëve të vullnetëshme dhe të mirëinformuara. Vlera e drejtë e makinerive dhe pajisjeve bazohet në sjelljen e tregut dhe të kostove duke përdorur cmimet e kuotuar në treg për artikuj të ngjashëm apo koston e zëvendësimit kur është e nevojshme.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

4. Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

(ii) Llogaritë e arkëtueshme

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, përcaktohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare, aktualizuar me normën e interesit të tregut ne datën e raportimit. Vlera e drejtë në këtë rast përcaktohet për efekte të shënimeve shpjeguese.

(iii) Detyrimet financiare jo-derivative

Vlera e drejtë, përcaktuar për shënimet shpjeguese, llogaritet bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të principalit e interesave, aktualizuar me normën e interesit të tregut ne datën e raportimit. Për qeratë financiare, norma e interesit të tregut përcaktohet nga kontratat e ngjashme apo referencë të qerave.

5. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqeria është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtëme si pasojë e përdorimit të instrumentave financiare:

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Shoqerisë ndaj secilit prej llojeve të risqeve, objektivave, politikave dhe proceseve për matjen dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqerisë. Shënime të tjera sasiore përfshihen ne pasyrat financiare.

Risku i kredisë

Risku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Shoqerisë që vjen nëse një klient apo palë e ngjashme me të nuk përmbush detyrimet kontraktuale, dhe buron kryesisht nga të arkëtueshmet nga klientët dhe investimet në letra me vlerë. Shoqeria ka një numër shume të madh klientesh të cilat janë familjare, institucione buxhetore dhe entitete private të ndryshme. Ky diversifikim i klienteve minimizon në një masë të konsiderueshme rrezikun e kredisë.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqeria të hasë vështirësi për të plotësuar detyrimet financiare që shlyhen duke dhënë mjete monetare ose aktive të tjera financiare. Qëndrimi i Shoqerisë në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë se do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar detyrimet kur ato maturohen, si në kushte normale dhe të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo dëmtuar reputacionin e Shoqerisë. Aktualisht shoqeria ka hasur vështirësi në kryerjen e pagesave të huase italiane, dhe ka qene MF ajo ajo që ka bere pagesen, ne rastet e mos likuidimit nga ana e UKT.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në cmimet e tregut, sic janë kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të prekin rezultatin e Shoqerisë. Aktiviteti i UKT dhe në menyre të veçante cmimet e shitjes së ujit janë të rregulluara nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), i cili harmonizon interesat e shoqerisë dhe të konsumatorit.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

5. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i tregut (vazhdon)

Risku i interesit

Shoqëria nuk ndeshet me riskun e interesit të flukseve monetare sepse ajo nuk ka instrumenta financiare me norma të variueshme.

Risku i monedhës së huaj

Shoqëria ka disa hua në monedha të huaja (Euro), të cilat janë për tu paguar në terma afatgjatë, rrjedhimisht risku me të cilin mund të ndeshet kompania kundrejt luhatjeve të monedhave të huaja është i kufizuar deri në masën e detyrimit afatshkurter, e cila nuk ze peshe të konsiderueshme në aktivitetin e shoqërisë.

Analiza e ndjeshmërisë

Në manaxhimin e riskut të interesit dhe monedhës së huaj, Shoqëria synon të reduktojë impaktin e luhatjeve afatshkurter në fitimet e saj. Megjithatë në planin afatgjatë, ndryshimet e qëndrueshme në kurset e këmbimit dhe interesa mund të kenë efekt në fitim. Në 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 është vlerësuar se një ndryshim në normat e interesit dhe vlerës se Lekut ndaj monedhave të tjera nuk do të kishte një impakt të rëndësishëm mbi fitimin para tatimit të Shoqërisë.

Manaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali, të ruajë besueshmërinë që kanë investitorët, kreditorët dhe tregu si dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen.

Nuk ka patur ndryshime në qëndrimin e Shoqërisë ndaj manaxhimit të kapitalit gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave për kapital të imponuara nga jashtë.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rasis kur specifkohet monedha tjetër)

6. Toka, ndërtesa, makineri e paisje

Toka, ndërtesa, makineri e paisje konsiston si më poshtë:

	Toka	Ndërtesa	Makineri e paisje	Mjete transporti	Rrjet Kanalizime	Rrjetit Ujësjetilës	Paisje zyrash	Aktive në process	Totali
Vlera bruto									
Në 01 Janar 2010	1,549,188,211	4,286,375,135	113,427,840	213,899,690	631,754,364	2,152,936,262	113,454,862	59,527,940	9,120,564,306
Shtesa	23,865,985	92,211,765	21,338,277	385,000	33,033,035	300,946,690	7,265,810	116,597,633	595,664,194
Transferime			(604,000)	604,000					0
Pakësime								59,527,940	59,527,940
Në 31 Dhjetor 2010	1,573,054,196	4,378,586,900	134,162,117	214,888,690	664,807,399	2,453,882,952	120,720,672	116,597,633	9,656,700,560
Amortizimi i akumuluar									
Në 1 Janar 2010		478,033,644	55,122,545	97,782,612	66,813,696	262,970,421	68,406,235		1,029,129,155
Amortizime për vitin 2010		164,730,527	6,650,990	15,001,857	31,389,609	141,566,429	19,624,201		378,963,611
Zhvlerësimet			2,720,205	967,439			403,588		4,091,232
Pakësime									0
Në 31 Dhjetor 2010		642,764,171	64,493,740	113,751,908	98,203,305	404,536,851	88,434,024	0	1,412,183,998
Vlera Neto									
Në 31 Dhjetor 2009	1,549,188,211	3,808,341,491	58,305,295	116,117,078	564,940,668	1889,965,841	45,048,627	59,527,940	8,091,435,151
Në 31 Dhjetor 2010	1573,054,196	3,735,822,729	69,668,377	101,136,782	566,604,094	2,049,346,101	32,286,648	116,597,633	8,244,516,562

Shoqëria nuk ka vënë asnjë pasuri si garanci apo peng për llogari të të tretëve më datë 31 Dhjetor 2010.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

7. Aktive të tjera afat gjatë

Perfaqeson vlerën e huase e cila është disbursuar nga banka agjente konform kontrates se huase, por UKT sh.a ende nuk ka marrë një situacion për perdorimin e kesaj huaje nga DPUK si pasoje UKT sh.a mendon se kjo pjese e huase duhet pasqyruar si aktive afat gjate ne proces deri ne momentin qe do te kete informacion me te plote rreth perdorimit te saj.

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Aktive te tjera afat gjate	445,929,705	443,326,815
Totali	445,929,705	443,326,815

8. Inventari

Inventari perfaqeson vleren e materialeve ne magazine te vleresuar me vleren e drejte.

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Inventare	247,584,390	138,840,991
Provizione per zhvleresime	(14,975,851)	(12,358,570)
Totali	232,608,539	126,482,421

9. Llogari per tu arkëtuar (kliente)

Perfaqeson vleren neto te arketueshme te llogarise kliente sipas gjykimit te drejtuesve te shoqrise. Shuma e provizioneve per mos arketim eshte llogaritur mbi bazen e vjetersise se llogarive per tu arketuar dhe kategorise se tyre.

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Klientë	2,525,228,518	2,292,636,727
Provizione per zhvleresime	(1,465,209,247)	(1,308,332,472)
Totali	1,060,019,271	984,304,255

Shuma e mësipërme përbëhet nga kliente te shumte individuale qe perfaqesojne subjekte private, shtetore dhe individe familjare si me poshte:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Konsumatore familjare	1,608,904,237	1,326,938,570
Subjekte private	544,328,272	473,420,872
Ente buxhetore	214,702,672	164,132,513
Te tjera	157,293,337	328,144,772
Totali	2,525,228,518	2,292,636,727

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

10. Te tjera aktive afat shkurter

Të tjera aktive afat shkurtër përbëhet:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Te arketueshme nga personeli	9,603,638	9,323,434
Tatim fitimi i parapaguar	18,014,916	5,246,799
TVSH per tu rimbursuar	3,316,251	0
Te tjera aktive afat shkurter	10,788,877	13,152,056
Provizione per zhvleresim te aktiveve afat shkurter	(16,946,640)	(16,626,236)
Totali	24,777,042	11,096,053

11. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjete monetare dhe ekujvalente të tyre përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Mjete monetare në arkë	300	296
Llogari Bankare		
Në Lek	41,196,917	51,325,128
Në Monedha te huaja	520,652	607,035
Totali	41,717,869	51,858,263
Llogari bankare te zbuluara		0
Mjete monetare dhe ekujvalente të tyre ne pasqyrën e flukseve monetare:	41,717,869	51,858,263

12. Kapitalet e veta

Kapitalet e veta përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Kapitali aksioner	2,561,571,000	2,561,571,000
Rezerva statutore	66,255,787	66,391,287
Rezerva ligjore	3,680,738	3,680,738
Rezerva rivleresimi	2,700,676,118	2,700,676,118
Fitim (humbje) te mbartura	(2,036,388,426)	(1,304,050,202)
Fitim (humbje) te periudhes	245,620,761	(732,338,222)
Totali	3,541,415,978	3,295,930,719

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

13. Hua afat gjate

Llogaritë e huave afat gjate përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Huaja per impjantin e Bovilles Faza I	750,530,667	797,608,439
Huaja per impjantin e Bovilles Faza II	1,357,724,158	1,436,882,841
Huaja per rrjetin e ujesjellesit	2,200,626,877	2,187,781,933
Huaja per elektropompa	81,157,282	80,683,560
Huaja per punime shtese ne Boville	837,463,000	864,463,000
(minus kestin afat shkurter)	(139,355,831)	(138,542,412)
Totali	5,088,146,153	5,228,877,361

Huaja per impjantin e Bovilles (Faza I) eshte financuar nga qeveria Italiane ne vitin 1996 fillimisht ne shumen 13 miliard lireta me interes prej 1% ne vit. Ne vitin 2002 huaja eshte konvertuar ne Euro per pjesen e papaguar (sipas kursit zyrtar te kalimit ne monedhen e re 1E=1,936.27lit) ne shumen ekuivalente 6,713,939 Euro.

Huaja per impjantin e Bovilles (Faza II) eshte financuar nga qeveria Italiane ne vitin 1996 fillimisht ne shumen 22 miliard lireta me interes prej 1% ne vit. Ne vitin 2002 huaja eshte konvertuar ne Euro per pjesen e papaguar (sipas kursit zyrtar te kalimit ne monedhen e re 1E=1,936.27lit) ne shumen ekuivalente 11,346,693 Euro. Huaja ka nje afat ripagimi per tridhjetë vjet dhe afatet e pagesave per pese vitet e ardhëshme jane si me poshte:

Viti	Huaja per Fazen I	Huaja per Fazen II	Totali (ne Euro)
2011	372,997	631,225	1,004,222
2012	372,997	631,225	1,004,222
2013	372,997	631,225	1,004,222
2014	372,997	631,225	1,004,222
2015	372,997	631,225	1,004,222
Mbas vitit 2015			10,192,439
Totali i pagesave (Euro)			15,192,440
Totali i pagesave ne Lek			2,108,254,825

Kesti afat shkurter i huase prej 1,004,222 Euro (ose 139,355,831 Lek) eshte pasqyruar ne pjesen e detyrimeve afat-shkurter te bilancit.

Huaja per rrjetin, eshte financuar nga qeveria Italiane ne vitin 1999, fillimisht ne shumen 60 miliard lireta me interes 0.5% ne vit. Ne vitin 2002 huaja eshte konvertuar ne Euro per pjesen e papaguar (sipas kursit zyrtar te kalimit ne monedhen e re 1E=1,936.27lit) ne shumen ekuivalente 15,858,088 Euro. Ripagimi i huase fillon ne vitin 2024 me keste ne çdo gjashte muaj per nje periudhe tridhjetë vjecare.

Ne totalin e kesaj huaje, UKT sh.a ka regjistruar nje shume prej 2,628,612 Euro e cila vjen si rezultat i disbursimit te huase nga DPUK. Ne fakt UKT sh.a nuk ka nje situacion per perdorimin e kesaj huaje, rrjedhimisht kunderpartia e saj eshte konsideruar si aktive afatgjate ne proces.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

13. Hua afat gjate (vazhdon)

Huaja për elektropompa e financuar nga qeveria italiane në vitin 1999 fillimisht në shumën 1,132,394,687 miliard lireta me 1% interes në vit. Në vitin 2002 huaja është konvertuar në Euro për pjesën e papaguar (sipas kursit zyrtar të kalimit në monedhën e re 1E=1,936.27 Lireta) në shumën ekuivalente 584,833 Euro. Ripagimi i huasë fillon në Dhjetor të vitit 2011 dhe do paguhet me keste në çdo gjashtë muaj për një periudhë prej 18 vjecare.

Huaja për punime shtese në Boville është financuar fillimisht nga Banka e Kursimeve (sot Raiffaissen Bank). Kjo hua në vitin 2001 ka kaluar pranë Agjensisë së Trajtimit të Kredive (ATK) dhe është bërë konvertimi në Leke. Teprica e pa paguar në datën e mbylljes së bilancit është 837,463,000 Lek. Shoqëria po negocion me autoritetin përkatës për ristrukturimin e termave të kësaj huaje, nga e cila shoqëria mund të perfitojë faljen e interesave në shumën 322,518,075 Leke. Për arsye se nuk ka ende një qendrim të qartë nga ATK, për faljen e ketyre interesave, UKT sh.a nuk e ka njohur këtë të ardhur në pasqyrat financiare të mbyllura në datën 31.12.2010

Të gjitha huatë janë të garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Financave, e cila në rast mospagese nga UKT kryen pagesën e kështit dhe interesit përkatës tek financuesi. Shumat e paguara deri tani nga Ministria e Financës për llogaritë të UKT sh.a janë:

Shumat e paguara për shlyerje të principali 304,592,071 Lek (Euro 1,692,830)

Shumat e paguara për shlyerje të interesash 23,599,831 Lek (Euro 170,060)

14. Grante

Llogaritë e granteve përbehen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Grante për investime	568,269,995	538,003,206
Totali	568,269,995	538,003,206

Grantet janë dhënë nga buxheti i qeverisë qendrore për të mundësuar nevojat për investime në sektorin e ujësjetillësit. Këto grante janë porëndur konform qëllimit për të cilin janë dhënë. Grantet janë amortizuar sipas metodës lineare duke i rimarrë në të ardhurat në proporcion me shpenzimet e amortizimit për ato aktive afat gjate materiale për të cilin ato janë porëndur.

15. Llogari të pagueshme

Llogari të pagueshme përbehen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Furnitorë mallra dhe shërbime	251,167,989	140,285,063
Furnitore për aktive afatgjate	21,173,465	6,394,388
Totali	272,341,453	146,679,452

Termat dhe kushtet e zerit llogari të pagueshme janë si më poshtë:

- Llogaritë e pagueshme nuk kanë detyrime për interesa dhe janë për tu paguar brenda ciklit të ardhshëm të biznesit.
- Përsa i përket manaxhimit të riskut të kreditimit, referojuni shënimeve më poshtë

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

16. Hua afat shkurter

Llogaria e huase afat shkurter perfaqeson detyrimin per pjesen e keshtit te paguar nga Ministria e Financave:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Detyrime ndaj Ministrise se Financave	304,592,071	233,542,955
Totali	304,592,071	233,542,955

17. Detyrime ndaj punonjesve

Detyrime ndaj punonjesve perbehen si me poshte:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Paga per tu paguar	31,843,930	22,658,005
Te tjera detyrime ndaj personelit	1,078,628	1,413,518
Totali	32,922,558	24,071,523

Detyrime te tjera perfaqesojne detyrime kundrejt anetareve te Keshillit te drejtimit, si dhe shuma te mbajtura per pensione uushqimore familjare.

18. Te tjera detyrime afat shkurter

Detyrime të tjera afat shkurter përbëhet nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Detyrime per TVSH	0	30,839,141
Tatim mbi të ardhura personale	6,848,331	3,932,676
Sigurime shoqërore	10,829,716	8,229,034
Interesa per tu paguar	20,179,452	23,078,348
Te tjera detyrime	64,667,450	37,777,760
Totali	102,524,949	102,856,959

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

19. Të ardhurat

Të ardhurat nga aktiviteti kryesor reflektohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Shitje uji per konsumatore familjare	782,851,272	458,815,109
Shitje uji per institucione buxhetore	360,845,522	242,583,507
Shitje uji per subjekte private	452,283,132	320,054,015
Shitje uji Komuna e Bashki	28,491,260	16,337,600
Shitje uji per HEC	145,431,828	130,849,473
Tarifa fikse sherbimi	150,615,300	0
	1,920,518,314	1,168,639,704
Te ardhura te tjera		
Te ardhura nga instalimet	4,294,246	11,412,192
Te ardhura nga investime ne ekonomi	17,178,142	0
Te ardhura nga azhornimi	1,074,462	1,339,869
Kontrata te reja	28,426,831	14,380,000
Te ardhura te tjera	2,210,298	1,418,654
	53,183,979	28,550,715
Totali	1,973,702,293	1,197,190,419

20. Shpenzime operacionale

Shpenzimet operacionale përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Materiale	187,149,416	128,995,881
Energji elektrike	248,374,966	199,332,087
Roje private	48,017,022	33,843,832
Karburant	24,423,756	14,517,653
Shërbime postare dhe komunikacion	2,099,712	2,930,184
Qera	3,019,125	609,000
Shpenzime të tjera	19,989,558	7,753,196
Total	533,073,555	387,981,834

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

21. Shpenzime per personelin

Shpenzimet per personelin përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Paga dhe shperblime	521,257,276	392,773,776
Sigurime shoqerore shendetesore	70,936,898	64,347,558
Total	592,194,174	457,121,334

22. Shpenzime te tjera

Shpenzimet te tjera përbëhet nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Reklama e publicitet	5,214,753	586,800
Udhetime e dieta	5,584,912	81,366
Sherbime bankare	2,187,529	1,183,239
Taksa dhe te ngjashme	21,351,835	14,897,433
Te tjera	1,483,306	306,000
Total	35,822,335	17,054,838

23. Tatimi mbi fitimin

Norma e tatimi mbi fitimin është 10% (2009; 10%). Shpenzimet e pazbritshme për efekt të tatimit mbi fitimin janë llogaritur në përputhje me ligjin Nr. 8438 date 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat". Shoqëria megjithëse ka realizuar një fitim të tatueshem prej 420,490,402 Lek (2009; humbje 475,908,775 Lek), nuk ka detyrime per tatim mbi fitimin, si pasoje e mbartjes se humbjes fiskale te vitit te kaluar. Humbja e mbartur per vitet e ardheshme ngelet ne shumen 55,490,373 Lek.

24. Veprime me palët e lidhura

Shoqëria konsideron transaksionet me degen e thesarit si transaksione me palë të lidhura si më poshte:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009 (Riparaqitur)
Grante per investime afta gjate	44,862,646	2,832,340
Totali	44,862,646	2,832,340

25. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Detyrime të mundshme

Shoqëria nuk ka detyrime të mundshme në datën 31 Dhjetor 2010.

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

26. Manaxhimi i riskut

(i) Rreziku i kreditimit dhe përqëndrimi

Ekspozimi ndaj riskut të kreditimit:

Vlera e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit ndaj kreditimit. Maksimumi i ekspozimit ndaj riskut të kreditimit në datën e raportimit ishte:

	31 Dhjetor	
	2010	2009
(ne 000 Lek)		
Kliente dhe aktive të tjera afatshkurter	1,317,405	1,121,883
Mjete monetare ne arkë dhe bankë	41,718	51,859
	1,359,122	1,173,742

Ekspozimi ndaj riskut të kreditimit për aktivet financiare në datën e raportimit sipas rajoneve gjeografike ishte:

	31 Dhjetor	
	2010	2009
(ne 000 Lek)		
Lokal	1,359,122	1,173,742
Jo-Lokal	0	0
	1,359,122	1,173,742

(ii) Risku i këmbimeve monetare

Shoqëria kryen transaksione në LEK dhe në EURO. Shoqëria nuk ka kryer ndonjë transaksion forward ose të produkt derivative të fiksuar ne datën 31 Dhjetor 2010

Ekspozimi ndaj riskut monedhave të huaja

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të monedhave të huaja në datën 31 Dhjetor 2010 ka qënë si me poshte:

31 Dhjetor 2010 (ne 000 Lek)	Vlera e mbartur	Euro	USD	Lek
Kliente dhe llogari të tjera të arketueshme	1,085,117	0	0	1,085,117
Likujditete ne arke dhe bank	41,718	105	415	41,198
Hua bankare	(5,088,146)	(4,250,683)		(837,463)
Overdrafte	0	0	0	0
Llogari të pagueshme	(851,664)	0	0	(851,664)
Ekspozimi neto	(4,812,975)	(4,250,578)	415	(562,812)

Kurset e këmbimit që janë përdorur gjatë vitit:

Lek	Kursi mesatar		Kursi në datën e bilancit	
	2010	2009	2010	2009
EURO 1	138.81	132,04	138.77	137,96

Shpjegime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

26. Manaxhimi i riskut (vazhdon)


(iii) Risku i likuiditetit

Shoqërisë i duhet të mbulojë nevojat për likuiditet nga operacionet e veta të prodhimit apo tregëtimit. Prandaj mund të kete rreziqe që nuk do të ketë likuiditete të mjaftueshme për të paguar detyrimet sipas afateve në kosto të arsyeshme. Shoqëria e rishikon riskun e likuiditetit në baza periodike në mënyrë që të manaxhohen detyrimet kur i vjen koha.

27. Ngjarje mbas mbylljes së bilancit

Mbas dates së mbylljes së bilancit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme e cila kërkon regullime të pasqyrave financiare, apo dhënien e shpjegimeve plotësuese për to.

**PER SEK. E KONTABILITETIT
ROZINA FRANJA**



**DREJTOR DEP. EKONOMIK
ELDAR KAZO**



**DREJTORI I PËRGJITHSHEM
SAHIT DOLLAPI**

